# UDHËZUES PËRDORIMI PËR BKT SMARTBANKOMAT

PREJ 1925

BANKA KOMBETARE TREGTARE

BANKA KOMBETARE TREGTARE

# PËRMBAJTJA

I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM ..... 6
1. KUSHTET E DOMOSDOSHME PËR PËRDORIMIN E SMART BANKOMAT ..... 6
2. INFORMACION NË EKRANIN FILLESTAR TË SMART BANKOMAT ..... 6

II. AKSESIMI NË SMART BANKOMAT PËR KLIENTËT E BKT-SË ..... 7
1. IDENTIFIKIMI ME KARTË DEBITI OSE KREDITI TË BKT-SË ..... 7
2. MENU KRYESORE ..... 8
2.1. Hapësira fillestare ..... 8
2.2. Tërheqje e shpejtë ..... 9
2.3. Transaksionet ..... 9
2.4. Hapësirë informuese mbi limitet ditore ..... 10
2.5. Hapësira fundore ..... 10

III. LISTA E VEPRIMEVE NË SMART BANKOMAT PËR KLIENTËT E BKT-SË ..... 11
1. TËRHEQJE E SHPEJTË ..... 11
2. TËRHEQJE ..... 13
2.1. Aksesimi i procesit së tërheqjes në menunë kryesore ..... 13
2.2. Zgjedhja e llogarisë nga e cila dëshironi të tërhiqni fondet ..... 13
2.3. Zgjedhja e shumës që dëshironi të tërhiqni ..... 14
2.4. Konfirmimi i transaksionit ..... 16
2.5. Pajisja me faturë ..... 16
3. DEPOZITIME ..... 17
3.1. Aksesimi i menusë së depozitimit ..... 17
3.2. Zgjedhja e llogarisë ku dëshironi të depozitoni fondet ..... 18
3.3. Depozitimi i parave ..... 19
3.4. Përmbledhja e transaksionit ..... 19
3.5. Pajisja me faturë ..... 20
3.6. Përfundimi i transaksionit ..... 21
4. GJENDJA E LLOGARISË ..... 22
4.1. Aksesimi i menusë "Sa gjendje kam?" ..... 22
4.2. Përzgjedhja e llogarisë ..... 23
4.3. Printimi i faturës së gjendjes së llogarisë ..... 24
5. KARTAT E KREDITIT ..... 25
5.1. Pagesa e kartës tuaj të kreditit ..... 26
5.2. Pagesa e një karte krediti të një klienti tjetër ..... 29
5.3. Detajet e Kartës së Kreditit ..... 32
6. PËRDITËSIMI I EMAIL ..... 33
6.1. Aksesimi i menusë së ndryshimit të adresës së Email-it ..... 33
6.2. Ndryshimi i adresës së Email-it tuaj ..... 35
6.3. Konfirmimi i ndryshimit të adresës së Email-it ..... 36
7. NDRYSHIM I PIN ..... 36
7.1. Aksesimi i menusë së ndryshimit të PIN ..... 36

7.2. Vendosja e PIN-it të ri ........ 38
7.3. Konfirmimi i ndryshimit të PIN-it ........ 38

**8. RIMBUSHJE CELULARI ........ 39**
8.1. Aksesimi i menusë së rimbushjes së celularit ........ 39
8.2. Zgjedhja e operatorit telefonik ........ 40
8.3. Vendosja e numrit celular nga tastiera numerike ........ 41
8.4. Rimbushja “Standard Top Up” dhe paketat e ofruara ........ 42
8.5. Zgjedhja e shumës së rimbushjes ........ 42
8.6. Zgjedhja e llogarisë për të kryer rimbushjen ........ 43
8.7. Përmbledhja e transaksionit ........ 43
8.8. Pajisja me faturë ........ 44
8.9. Konfirmimi i Transaksionit ........ 45

**9. HISTORIKU I TRANSAKSIONEVE ........ 46**
9.1. Aksesimi i menusë së historikut të transaksioneve ........ 46
9.2. Zgjedhja e llogarisë së historikut të transaksioneve ........ 47
9.3. Zgjedhja e e intervalit kohor të dëshiruar ........ 48
9.4. Dërgesa e transaksionit në adresën e Email ........ 48

**10. LLOGARITË E MIA ........ 49**
10.1. Aksesimi i menusë Llogaritë e mia ........ 49
10.2. Lista e llogarive ........ 51
10.3. Dërgo me E-mail ........ 51

**11. PAGESAT E SHËRBIMEVE UTILITARE (UJË DHE ENERGJI ELEKTRIKE) ........ 52**
11.1. Aksesimi i menusë Hamburger ........ 52
11.2. Aksesimi i menusë së Pagesave ........ 53
11.3. Zgjedhja e kategorisë së pagesës ........ 53
11.4. Zgjedhja e institucionit ........ 54
11.5. Zgjedhja e faturës për të paguar ........ 54
11.6. Zgjedhja e llogarisë për të kryer pagesën ........ 56
11.7. Përmbledhja e transaksionit ........ 56
11.8. Pajisja me faturë ........ 57

**12. PAGESA EDUKIMI ........ 58**
12.1. Aksesimi i menusë Hamburger ........ 58
12.2. Aksesimi i menusë së pagesave ........ 59
12.3. Zgjedhja e kategorisë së pagesës ........ 60
12.4. Zgjedhja e institucionit ........ 61
12.5. Zgjedhja e shërbimit ........ 61
12.6. Detajet e pagesës ........ 62
12.7. Zgjedhja e shumës për të paguar ........ 62
12.8. Përmbledhja e transaksionit ........ 63

**13. TRANSFERTË E BRENDSHME NËPËRMJET CIF/NUMRIT TË LLOGARISË/NUMRIT TË CELULARIT ........ 64**
13.1. Aksesimi i menusë për Transferta brenda BKT ........ 64
13.2. Aksesimi i menusë së transfertave ........ 65
13.3. Përzgjedhja e llogarisë nga ku do të kalojnë fondet ........ 65
13.4. Vendosja e shumës së Transfertës ........ 66
13.5. Vendosja e të dhënave për përfituesin ........ 66
13.6. Përmbledhja e Transaksionit ........ 67
13.7. Pajisja me faturë ........ 68
13.8. Konfirmimi i Transaksionit ........ 69

IV. AKSESIMI NË SMART BANKOMAT PËR JO KLIENTËT E BKT-SË ....................... 69
1. IDENTIFIKIMI ME KARTË DEBITI OSE KREDITI TË JO BKT-SË ....................... 69
2. MENU KRYESORE ....................... 70
2.1 Hapësira fillestare ....................... 70
2.2 Tërheqje e shpejtë ....................... 70
2.3 Transaksionet ....................... 71
2.4 Hapësira fundore ....................... 71
3. TËRHEQJE ....................... 72
3.1. Aksesimi i menusë së Tërheqjes ....................... 72
3.2. Zgjedhja e shumës ....................... 72
3.3. Konfirmimi i transaksionit ....................... 73
3.4. Pajisja me faturë ....................... 74
4. BALANCA E LLOGARISË ....................... 75
4.1. Aksesimi i menusë së balances ....................... 75
4.2. Printimi i faturës me informacionin e balancës ....................... 76
4.3. Shfaqja e balancës ....................... 77
5. NDRYSHIMI I PIN-IT TË KARTËS TUAJ ....................... 78
5.1. Aksesimi i ndryshimit të PIN-it në menunë kryesore ....................... 78
5.2. Vendosja dhe konfirmimi i PIN-it të ri ....................... 79
5.3. Konfirmimi i ndryshimit të PIN ....................... 79
6. ZHBLLOKIM I PIN-IT TË KARTËS TUAJ ....................... 80
6.1. Aksesimi i zhbllokimit të PIN-it në menunë kryesore ....................... 80
6.2. Verifikim i PIN-it për zhbllokimin e tij ....................... 81
6.3. Konfirmimi i zhbllokimit të PIN-it ....................... 82

V. TRANSAKSIONE PA KARTË ....................... 83
1. TËRHEQJE ME KOD UNIK ....................... 84
1.1. Gjenerimi i Kodit Unik në aplikacionin BKT Smart ....................... 84
1.2. Tërheqja e parave në Smart BanKomaT ....................... 87
2. TËRHEQJE ME KOD QR ....................... 90
1.1. Inicimi i transaksionit në aplikacionin BKT Smart ....................... 91
1.2. Tërheqja e parave në Smart BanKomaT ....................... 92
3. DEPOZITIMI ME KOD QR ....................... 96
3.1. Inicimi i transaksionit në aplikacionin BKT Smart ....................... 96
3.2. Depozitimi i parave në Smart BanKomaT ....................... 98
4. RIMBUSHJE CELULARI PA KARTË ....................... 102
4.1. Aksesimi i menusë së Rimbushjes së Celularit pa kartë ....................... 102
4.2. Zgjedhja e operatorit celular ....................... 103
4.3. Vendosja e Numrit Celular ....................... 103
4.4. Depozitimi i kartëmonedhave ....................... 104
4.5. Përmbledhja e transaksionit ....................... 105
4.6. Rimbushja dhe zgjedhja e paketës ....................... 106
4.7. Përmbledhja e transaksionit ....................... 107
4.8. Pajisja me faturë ....................... 107
4.9. Konfirmimi i transaksionit ....................... 108
5. DEPOZITIMI I PARAVE PA KARTË PËR KLIENTË BKT (NGA NJË KLIENT BKT

TEK NJË KLIENT BKT) .......... 109
5.1. Aksesimi i menusë së depozitimit pa kartë .......... 109
5.2. Aksesimi i menusë së depozitimit për klient të BKT .......... 110
5.3. Vendosja e të dhënave tuaja (iniciuesit të veprimit) .......... 111
5.4. Dërgimi i Kodit 6-Shifror (FNP) .......... 111
5.5. Depozitimi i Parave në Smart BanKomaT .......... 112
5.6. Përmbledhja e transaksionit .......... 112
5.7. Vendosja e të dhënave të përfituesit .......... 113
5.8. Konfirmimi i Transaksionit .......... 114
5.9. Pajisja me faturë .......... 115
6. DEPOZITIM PA KARTË ME KOD UNIK PËR BIZNESET .......... 115
6.1. Gjenerimi i kodit Unik nga Dega Internet për Biznesin .......... 116
6.2. Depozitimi i fondeve me Kod Unik në ATM .......... 120
7. DEPOZITIM PA KARTË ME KOD QR PËR BIZNESET .......... 123
7.1. Aktivizimi i shërbimit dhe konfigurimi i punonjësit nga Dega Internet .......... 124
7.2. Depozitimi i fondeve me Kod QR në ATM .......... 128
8. KURSI I KËMBIMIT .......... 134
8.1. Aksesimi i menusë së Kursit të Këmbimit .......... 134
8.2. Përmbledhja e kursit të këmbimit .......... 135

VI. TRANSAKSIONE NË EPARA .......... 136
1. Inicimi i Transaskionit nga aplikacioni epara .......... 136
2. Tërheqja & Depozitimi i parave në Smart BanKomaT .......... 136
2.1. Aksesimi i menusë epara .......... 136
2.2. Skanimi i Kodit QR .......... 137

ANEKSI 1 – Limitet e transaksioneve në Smart BanKomaT .......... 138

# I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

## 1. KUSHTET E DOMOSDOSHME PËR PËRDORIMIN E SMART BANKOMAT

Terminali Smart BanKomaT mund të përdoret nëse:

1. Posedoni një kartë aktive Debiti ose Krediti të lëshuar nga Banka Kombëtare Tregtare.
2. Posedoni një kartë aktive Debiti ose Krediti të lëshuar nga një institucion i ndryshëm nga Banka Komëtare Tregtare.
3. Jeni mbi 18 vjeç dhe nuk posedoni asnjë kartë Debiti ose Krediti nëpërmjet menuve transaksioneve pa kartë.

## 2. INFORMACION NË EKRANIN FILLESTAR TË SMART BANKOMAT

Nëse ju vizitoni një Smart BanKomaT, ekrani fillestar do të shfaqet si më poshtë duke treguar informacione mbi:

- Datën & Orën aktuale
- Numrin e kontaktit të Shërbimit të Klientit
- Hapësirë informuese dhe reklamash për produktet dhe shërbimet e BKT
- Përmbledhje e transaksioneve që mund të kryhen në këtë terminal
- Valuta e pranuar për transaksionet me para cash
- Informacion mbi llojet e kartave që mund të përdoren në Smart BanKomaT
- Produktet & Shërbimet që ofron BKT
- Zgjedhjen e gjuhës për përdorimin e këtij terminali
- Kodin QR për të Tërhequr apo Depozituar para
- Transaksionet pa kartë në Smart BanKomaT
- Transaksione me epara




## II. AKSESIMI NË SMART BANKOMAT PËR KLIENTËT E BKT-SË

### 1. IDENTIFIKIMI ME KARTË DEBITI OSE KREDITI TË BKT-SË

Për të aksesuar Smart BanKomaT si klient i BKT-së nevojitet të posedoni:

a. *Kartë Debiti ose Krediti* (një mjet plastik në formë drejtkëndore të lëshuar nga BKT, unik për çdo klient, për të cilën kryhet një aplikim dhe posedohet fizikisht).

b. *PIN-in e Kartës tuaj* (një numër 4 shifror që merret nëpërmjet një zarfi ose SMS në momentin që aktivizohet një kartë debiti ose krediti).

Pasi ju të fusni kartën në pajisjen kartëlexuese të bankomatit, ju shfaqet ekrani i cili ju përshëndet nëpërmjet identifikimt të kartës suaj dhe ju fton të vendosni PIN-in e kartës nëpërmjet tastierës numerike.

Në këtë ekran ju keni mundësi të ndryshoni gjuhën e shërbimit të Smart BanKomaT duke

klikuar mbi butonin që tregon gjuhën aktuale.




## 2. MENU KRYESORE

Pasi keni vendosur PIN-in e kartës suaj, do t'ju shfaqet Menuja Kryesore e Smart BanKomaT. Kjo menu përmban:

### 2.1. Hapësira fillestare

1. Njoftimi i mirëseardhjes e personalizuar me emrin tuaj.
2. Butoni 

për të aksesuar menunë e ndryshimit të të dhënave personale.
3. Hapësirën informuese për produktet dhe shërbimet e BKT-së.
4. Butoni ⁝⁝⁝ për të aksesuar Hamburger Menu.

## 2.2. Tërheqje e shpejtë

1. Butoni 

për të zgjedhur valutën në Lekë për tërheqjen e shpejtë.

2. Butoni 

për të zgjedhur valutën në EUR për tërheqjen e shpejtë.

3. Shumat e personalizuara 

.

4. Butoni 

për të vendosur një shumë tjetër.

5. Butoni 

për të Tërhequr paratë menjëherë pasi keni zgjedhur shumën fillimisht.

## 2.3. Transaksionet

1. Butoni 

për të vijuar me Tërheqjen e parave.

2. Butoni 

për të vijuar me Depozitimin e parave.

3. Butoni 

për të parë gjendjen/balancën e llogarisë ose llogarive që janë të lidhura me kartën tuaj.

4. Butoni 

për të vijuar me menunë e Kartave të Kreditit.

5. Butoni 

për të vijuar me menunë tjetër.

## 2.4. Hapësirë informuese mbi limitet ditore

Në ekranin kryesor të Smart BanKomaT shfaqet informacion mbi limitet ditore të tërheqjes dhe depozitimit të parave, për transaksionet e kryera me kartë debiti.

Menjëherë pas autentikimit me kartë dhe PIN, dhe përpara kryerjes së ndonjë veprimi, në ekran shfaqen **limitet ditore maksimale** që dispononi për:

- Tërheqje parash
- Depozitim parash

Pas kryerjes së një transaksioni tërheqjeje ose depozitimi, informacioni mbi limitet përditësohet automatikisht dhe në ekran do të shfaqet **shuma e mbetur** që mund të përdorni për transaksionet e tjera gjatë të njëjtës ditë.

Ky informacion ju ndihmon të keni një pamje të qartë mbi kufijtë e përdorimit ditor dhe të planifikoni më mirë transaksionet tuaja në Smart BanKomaT.

## 2.5. Hapësira fundore

1. Butoni 

për të nxjerrë Kartën.
2. 

Informacion mbi Datën e Fundit të Hyrjes në Smart BanKomaT.
3. 

Informacion mbi numrin e kontaktit për Shërbimin ndaj Klientit.




## III. LISTA E VEPRIMEVE NË SMART BANKOMAT PËR KLIENTËT E BKT-SË

Në Smart BanKomaT ju mund të kryeni te gjitha veprimet e listuara më poshtë:

- Tërheqje e shpejtë
- Tërheqje
- Depozitime
- Rimbushje të celularit
- Pagesen e Kartave të kreditit
- Përditësimi i Email
- Ndryshimi i PIN
- Historiku i transaksioneve

### 1. TËRHEQJE E SHPEJTË

Në Smart BanKomaT ju keni mundësi të tërhiqni në mënyrë të shpejtë nga llogaria primare e lidhur me kartën e debitit në LEKË ose EUR nëpërmjet hapave të mëposhtme:

1. Kliko Valutën Lekë **ALL** ose **EUR**
2. Zgjidh **Shumën** ose Kliko butonin **Tjetër**
3. Kliko **Tërhiq Shpejt**

Nëse klikoni butonin 

do t'ju shfaqet ekrani si më poshtë i cili përmban:

1. Butonin **Anullo** për të kaluar sërish në menunë kryesore.
2. Fushën në të cilën ju mund të shkruani shumën që dëshironi nëpërmjet tastierës numerike.
3. Butonin **Vazhdo**, i cili bëhet i klikueshëm vetëm nëse vendoset një vlerë shumëfish i **500 ALL** ose **5 EUR** në fushën përkatëse.

*Për transaksionin Tërheqje e shpejtë opsioni i pajisjes me faturë nuk është i mundur kjo për të reduktuar hapat e transaksionit në mënyrë që transaksioni të kryhet në mënyrë të shpejtë.*




Kliko këtu për të Anulluar veprimin dhe për tu kthyer në faqen kryesore

Vendos shumën pa presje, nëpërmjet tastierës numerike

Kliko këtu pasi keni vendosur shumën, për të **tërhequr menjëherë paratë**

## 2. TËRHEQJE

Në Smart BanKomaT ju keni mundësi të tërhiqni nga llogaritë të lidhura me kartë e debitit në LEK ose EUR. Për të kryer këtë transaksion mjafton të ndiqni hapat si më poshtë.

### 2.1. Aksesimi i procesit së tërheqjes në menunë kryesore

Në menunë kryesore ju do të klikoni butonin: 





### 2.2. Zgjedhja e llogarisë nga e cila dëshironi të tërhiqni fondet

Pasi të klikoni këtë buton, do t'ju shfaqet imazhi si më poshtë i cili përmban:

1. Të gjitha llogaritë e lidhura me kartën e debitit të vendosur në Smart BanKomaT.
2. Informacionin bazë dhe balancën e maskuar.
3. Butoni për të shfaqur ose jo balancën e llogarisë.
4. Butoni për të zgjedhur llogarinë nga e cila doni të tërhiqni.
5. Butoni për të shfaqur detajet e llogarisë tuaj.
6. Butonin për të përfunduar sesionin duke marrë kartën tuaj sërish.
7. Butonin e Menusë Kryesore për të aksesuar menunë kryesore.




Ju mund të zgjidhni llogarinë nga e cila dëshironi të tërhiqni paratë duke klikuar mbi të.

Gjithashtu në këtë menu ju keni mundësi të:

- Kontrolloni balancën duke klikuar mbi butonin 

- Shikoni detajet mbi llogarinë duke klikuar mbi butonin 

- Dërgoni me E-Mail të dhënat e llogarisë duke klikuar mbi butonin 


### 2.3. Zgjedhja e shumës që dëshironi të tërhiqni

Pasi të keni zgjedhur llogarinë tuaj, në ketë hap do t'ju shfaqet ekrani si më poshtë i cili përmban:

1. Butoni 

për të zgjedhur monedhën në Lekë për tërheqjen.

2. Butoni 

për të zgjedhur valutën në EUR për tërheqjen.

3. Shumat e personalizuara 


4. Butoni  për të vendosur një shumë tjetër.


5. Butoni  për të tërhequr paratë tuaja pasi keni zgjedhur shumën fillimisht.


Për të vazhduar me tërheqjen duhet të ndiqni hapat si më poshtë:

1. Kliko Valutën Lekë (**ALL**) ose **EUR**
2. Zgjidh **Shumën** ose Kliko butonin **Tjetër**
3. Kliko **Tërhiq** ose **Vazhdo**

Nëse klikoni butonin  do t'ju shfaqet ekrani si më poshtë i cili përmban:


1. Butonin **Anulo** për të kaluar sërish në menunë kryesore
2. Fushën në të cilën ju mund të shkruani shumën që dëshironi nëpërmjet tastierës numerike.
3. Butonin **Vazhdo**, i cili bëhet i klikueshëm vetëm nëse vendoset një vlerë shumëfish i **500 ALL** ose **5 EUR** në fushën përkatëse.



### 2.4. Konfirmimi i transaksionit

Në qoftë se vendosni të vazhdoni më tej do t'ju shfaqet përmbledhja e informacionit të transaksionit. Nëse jeni dakord me shumën e shfaqur në ekran procedoni si më poshtë:

1. Klikoni mbi Butonin Konfirmo për të konfirmuar transaksionin tuaj dhe për të vazhduar më tej me tërheqjen.
2. Klikoni butonin Anulo për të anuluar transaksionin tuaj.




### 2.5. Pajisja me faturë

Pasi të keni konfirmuar transaksionin tuaj, në vijim do t'ju shfaqet ekrani në të cilin mund të zgjidhni nëse dëshironi të pajiseni me faturë ose jo për transaksionin që keni kryer.

- Klikoni mbi butonin Printo Faturen për tu pajisur me faturë
- Klikoni mbi butonin Dergo me Email për të marrë faturën elektronikisht në email-in që keni të regjistruar në llogarinë tuaj në BKT.

- Klikoni mbi butonin 

nëse nuk dëshironi të pajiseni as me faturë fizike as me faturë elektronike




## 3. DEPOZITIME

Ju mund të depozitoni para cash në monedhën LEK ose EUR në Smart BanKomaT.

### 3.1. Aksesimi i menusë së depozitimit

Për të depozituar në Smart BanKomaT duhet të klikoni në opsionin 

, i cili mund të aksesohet nga Menuja Kryesore pasi ju keni futur kartën tuaj.




### 3.2. Zgjedhja e llogarisë ku dëshironi të depozitoni fondet




Në ketë hap do ju shfaqet ekrani ku ju do të keni mundësinë të zgjidhni llogarinë në të cilën dëshironi të depozitoni fonde. Zgjidhni llogarinë që dëshironi të fusni fonde ose procedoni me anulimin e veprimit. Butonat e tjerë që do ju shfaqen janë:

1. Butoni Kthe Kartën

2. Butoni Balanca Fsheh për të shfaqur ose jo balancën e llogarisë

3. Butoni Menu Kryesore

### 3.3. Depozitimi i parave

Për të vazhduar me procesin e depozitimit të fondeve tuaja ju duhet të:

1. Vendosni paratë tuaja në hapësirën përkatëse në SmartBanKomaT.
2. Klikoni butonin Anulo për të anuluar veprimin.




### 3.4. Përmbledhja e transaksionit

Pas depozitimit të parave tuaja do ju shfaqet ky imazh i cili përmban butonat:

1. Butonin Konfirmo për të konfirmuar sasinë e kartëmonedhave të depozituara.
2. Butonin Shto për të shtuar para të tjera.

3. Butonin Anulo për të anuluar veprimin.




### 3.5. Pajisja me faturë

Pasi të keni konfirmuar transaksionin tuaj, në vijim do t'ju shfaqet ekrani në të cilin mund të zgjidhni nëse dëshironi të pajiseni me faturë ose jo për transaksionin që keni kryer.

- Klikoni mbi butonin Printo Faturen për tu pajisur me faturë
- Klikoni mbi butonin Dergo me Email për të marrë faturën elektronikisht në email-in që keni të regjistruar në llogarinë tuaj në BKT.
- Klikoni mbi butonin Jo faleminderit nëse nuk dëshironi të pajiseni as me faturë fizike as me faturë elektronike




### 3.6. Përfundimi i transaksionit

Në qoftë se transaksioni juaj është gjeneruar me sukses do t'ju shfaqet ekrani i cili tregon:

1. Shumën e depozituar
2. Balancën e re të llogarisë
3. Butonin 

 për të kthyer mbrapsht kartën tuaj
4. Butonin 

 për t'u kthyer në menunë kryesore




## 4. GJENDJA E LLOGARISË

Menuja "Sa gjendje kam?" ju mundëson të kontrolloni në çdo moment gjendjen e llogarisë ose llogarive që janë të lidhura me kartën tuaj të debitit, drejtpërdrejt nga Smart BanKomaT, përmes një procesi të thjeshtë.

### 4.1. Aksesimi i menusë "Sa gjendje kam?"

Pas autentikimit në Smart BanKomaT me kartë dhe PIN, nga Menuja Kryesore, klikoni butonin **"Sa gjendje kam?"**.




### 4.2. Përzgjedhja e llogarisë

Pasi të klikoni në menunë “Sa gjendje kam?”, në ekran do të shfaqet lista e llogarive që janë të lidhura me kartën tuaj.

Në ekran do të shfaqet informacioni kryesor i llogarisë, i paraqitur në mënyrë të strukturuar, duke përfshirë:

- Balancën e llogarisë
- Balancën e disponueshme
- Numrin e llogarisë

Për arsye sigurie, informacioni mbi gjendjen e llogarisë shfaqet fillimisht i maskuar. Për të parë informacionin e plotë për secilën nga llogaritë, klikoni ne butonin **“Balanca”**:

**BANKA KOMBETARE TREGTARE**




### 4.3. Printimi i faturës së gjendjes së llogarisë

Në rast se dëshironi të printoni faturën me gjendjen e llogarisë, nga lista e llogarive të shfaqura, zgjidhni llogarinë për të cilën dëshironi të shikoni gjendjen.

Në ekranin që do të shfaqet klikoni mbi butonin **"Printo Faturën"**.



## 5. KARTAT E KREDITIT

Në Smart BanKomaT, ju keni gjithashtu mundësi të kryeni disa lloje transaksionesh lidhur me Kartën e Kreditit duke klikuar mbi butonin **Kartat e Kreditit** në menunë kryesore.




Në ekranin e rradhës do t'ju shfaqet nënmenuja e Kartave të Kreditit e cila përmban të gjitha transaksionet që ju mund të kryeni me to duke përfshirë:

1. Butonin 

për të vijuar me Pagesën e kartës suaj

2. Butonin 

për të vijuar me Detajet e kartës suaj

3. Butonin 

për të vijuar me Pagesën e kartave të tjera të lëshuara nga BKT




### 5.1. Pagesa e kartës tuaj të kreditit

Ju mund të paguani kartën tuaj të kreditit nëpërmjet fondeve në llogaritë tuaja, në Smart BanKomaT

duke klikuar mbi menunë 

.

#### 5.1.1. Zgjedhja e kartës që dëshironi të paguani

Në hapin tjetër do t'ju shfaqet ekrani si më poshtë, ku ju do të keni mundësinë të zgjidhni një nga kartat që dëshironi të paguani duke naviguar me shigjetat majtas dhe djathtas.

1. Klikoni butonin **Vazhdo** për të vazhduar më tej me procesin.
2. Klikoni butonin **Prapa** për tu kthyer pas.




### 5.1.2. Zgjedhja e llogarisë nga e cila do të paguani kartën

Në qoftë se keni zgjedhur opsionin Vazhdo do ju shfaqet ekrani si më poshtë. Nëqoftëse keni më shumë se një llogari do ju shfaqen të gjitha llogaritë tuaja dhe mund të zgjidhni një nga llogaritë me të cilat dëshironi të vazhdoni me pagesën.

1. Klikoni butonin Prapa për tu kthyer pas.

2. Klikoni opsionin Balanca Fsheh për të fshehur balancën.




### 5.1.3. Zgjedhja e shumës së pagesës




Pasi të keni zgjedhur llogarinë nga e cila dëshironi të paguani, ju shfaqet ekrani më sipër ku mund të klikoni mbi ***Shumë e Plotë, Shumë Minimale*** ose ***Shumë tjetër*** dhe vendosni shumën nëpërmjet tastierës numerike.

Klikoni butonin Prapa për tu kthyer pas ose butonin Vazhdo, i cili do të ngjyroset kur ju të keni futur shumën tuaj nga tastiera numerike.

### 5.1.4. Detajet e transaksionit dhe konfirmimit

Kur të keni futur shumën tuaj do ju shfaqet dritarja përmbledhëse me emrin e kartëmbajtësit, numrin e llogarisë dhe shumën e pagesës tuaj. Klikoni Konfirmo për të vazhduar me pagesën e kartës së kreditit ose butonin Anulo për të anulluar veprimin.




## 5.2. Pagesa e një karte krediti të një klienti tjetër

Ju keni mundësi të paguani Kartën e Kreditit të një klienti të BKT-së duke klikuar mbi menunë



.

### 5.2.1. Vendosja e numrit të kartës së kreditit

Vendosni tek fusha **Numri i Kartës**, numrin e kartës që ju dëshironi të paguani, nëpërmjet tastierës numerike dhe klikoni mbi **Verifiko** për të verifikuar numrin e kartës që dëshironi të paguani.

Klikoni butonin Kthe Kartën për të marrë kartën tuaj mbrapsht ose Prapa për tu kthyer pas.




### 5.2.2. Verifikimi i kartëmbajtësit dhe konfirmimi i veprimit

Në hapin e rradhës do t'ju shfaqen detajet mbi transaksionin dhe emrin e kartëmbajtësit. Klikoni Konfirmo për te vazhduar me pagesën e kartës së kreditit ose butonin Anulo për të anulluar veprimin.




### 5.2.3. Përfundimi i Transaksionit

Nëqoftëse transaksioni juaj është gjeneruar me sukses do t'ju shfaqet ekrani i cili tregon:

1. Statusin e transaksionit
2. Butonin   për të kthyer mbrapsht kartën tuaj
3. Butonin   për t'u kthyer në menunë kryesore




### 5.3. Detajet e Kartës së Kreditit

Ju mund të shikoni detajet e kartës suaj të kreditit në çdo Smart BanKomaT duke klikuar mbi menunë 

. Mjafton vetëm të jeni i pajisur me një kartë krediti të lëshuar nga BKT.

#### 5.3.1. Shfaqja e detajeve të kartës së kreditit

Në hapin vijues do ju shfaqet imazhi përmbledhës me detajet e kartës suaj të kreditit. Klikoni mbi butonin **Prapa** për tu kthyer pas.




## 6. PËRDITËSIMI I EMAIL

Në Smart BanKomaT ju keni mundësi të ndryshoni adresën tuaj E-mail. Për të vijuar me ndryshimin ndiqni hapat e mëposhtme.

### 6.1. Aksesimi i menusë së ndryshimit të adresës së Email-it

Për të ndryshuar adresën tuaj të Email-it mund të ndiqni një nga dy mënyrat:

1. Klikoni në butonin 

në menunë kryesore dhe më pas në menunë e rradhës klikoni butonin 


2. Klikoni në mesazhin e mirëseardhjes 

në hapësirën fillestare në menunë kryesore dhe më pas në ekranin e rradhës klikoni në butonin 







Pasi të keni ndjekur një nga dy hapat e lartëpërmendur, do t'ju shfaqet ekrani me mundësinë për të përditësuar Emailin tuaj. Klikoni mbi ***Përditëso Email-in*** për të vazhduar me procesin e ndryshimit.




## 6.2. Ndryshimi i adresës së Email-it tuaj




Ndryshoni informacionin e kontaktit (Email) duke duke vendosur Email-in e ri nga tastiera virtuale që do t'ju shfaqet në ekran dhe klikoni mbi butonin **Go** në tastierën virtuale kur të keni përfunduar vendosjen e plotë të adresës e-mail.

### 6.3. Konfirmimi i ndryshimit të adresës së Email-it




Në vijim do ju shfaqet ekrani si më sipër me mesazhin se Adresa E-mail është ndryshuar me sukses dhe se një Email konfirmimi është dërguar në adresën tuaj të mëparshme dhe të re të Emailit.

Klikoni mbi Kthe Kartën për të marrë kartën tuaj mbrapsht ose mbi Menu Kryesore për tu kthyer në menunë kryesore.

## 7. NDRYSHIM I PIN

Ju mund të ndryshoni PIN-in e kartës tuaj të Debitit apo Kreditit në çdo Smart BanKomaT.

### 7.1. Aksesimi i menusë së ndryshimit të PIN

Për të aksesuar këtë veprim klikoni në menunë Më shumë dhe më pas Kliko mbi butonin Ndryshim PIN.


v.4.3.0.20
Mirësevini
TI MUND TË KONTROLLOSH BALANCËN
TËNDE SHUMË THJESHT NË BKT SMART!
ALL 5,000
ALL 2,000
ALL 10,000
Tërhiq Shpejt
ALL 1,000
ALL 40,000
ALL TJETER
EUR
Zgjidhni Shumën dhe klikoni Tërhiq Shpejt
Tërheqje
Sa gjendje kam?
Më shumë
Depozitime
Kartat e kreditit
Limiti ditor i mbetur për Tërheqje: 75000 Lekë / ekuivalent në Euro
Limiti ditor i mbetur për Depozi
950000 Lekë ose 5000 Euro
Kthe Kartën
Data e Fundit e Hyrjes
17.12.2025, 02:17 PM
Shërbimi ndaj klientit
+355 4 22 66 288
Kliko këtu për të aksesuar menutë e tjera


v.4.3.0.20a
Mirësevini
[redacted]
Zgjidhni një nga menutë duke klikuar mbi të
Kliko këtu për të ndryshuar PIN
Rimbushje Celulari
Përditësoni Profilin
Ndryshim PIN
Llogaritë e Mia
Historiku i Transaksioneve
Kthe Kartën
Prapa

### 7.2. Vendosja e PIN-it të ri

Në hapin e rradhës do t'ju shfaqet imazhi i cili ju kërkon të vendosni PIN-in e ri. Shkruani menjëherë nëpërmjet tastierës numerike PIN-in e ri 4 shifror. Pas validimit, rivendoseni sërish të njëjtin PIN.




### 7.3. Konfirmimi i ndryshimit të PIN-it



Pasi të keni vendosur PIN e ri do të merrni mesazhin e konfirmimit se PIN-i juaj i ri është ndryshuar me sukses.
Kini parasysh të mbani mend PIN-in tuaj të ri dhe mos e ndani atë me njerëz të tjerë.

## 8. RIMBUSHJE CELULARI

Ju mund të zgjidhni të rimbushni apratin tuaj celular nga çdo Smart BanKomaT. Mjafton të ndiqni hapat si më poshtë për të kryer transaksionin me sukses.

### 8.1. Aksesimi i menusë së rimbushjes së celularit

Për të aksesuar menunë fillimisht duhet të klikoni mbi menunë **"Më shumë"** Më shumë dhe me pas në ekranin që do të shfaqet përzgjidhni menunë: **"Rimbushje Celulari"** Rimbushje Celulari.






### 8.2. Zgjedhja e operatorit telefonik

Pasi të keni klikuar mbi menunë *Rimbushje Celulari* do ju shfaqet imazhi si më poshtë ku ju kërkohet të zgjidhni një nga operatorët celularë.



## 8.3. Vendosja e numrit celular nga tastiera numerike

Pasi të keni zgjedhur operatorin do ju shfaqet ekrani si më poshtë i cili përmban:

1. Fushën **Numri Celular** për të shkruar numrin tuaj në formatin +3556xxxxxxxx.
2. Butonin Prapa për tu kthyer prapa.
3. Butonin për Vazhdo të vazhduar më tej me procesin e rimbushjes.
4. Fusha Numri Celular +355 ku ju mund të vendosni numrin nga tastiera numerike në BanKomaT e celularit që ju doni të rimbushni.
5. Butoni për OFERTA Shfaq të shfaqur oferta lidhur me kompaninë celulare të selektuar.



### 8.4. Rimbushja "Standard Top Up" dhe paketat e ofruara

Në këtë hap ju do të keni mundësinë të zgjidhni nëse dëshironi vetëm të rimbushni numrin tuaj nëpërmjet menusë **"Standard Top Up"** ose të zgjidhni të aktivizoni një paketë se bashku me rimbushjen për celularin tuaj. Në ekran, do t'ju shfaqen paketat e ofruara nga kompania juaj celulare. Klikoni mbi një nga paketat që ju dëshironi dhe klikoni mbi butonin **"Shfaq"** nëse dëshironi të shikoni detajet përkatëse për paketat.




### 8.5. Zgjedhja e shumës së rimbushjes

Nëse keni zgjedhur paketën ***Standard Top Up***, klikoni mbi një nga shumat e shfaqura që dëshironi si në ekranin më sipër dhe butonin për të vazhduar me rimbushjen ose butonin **Prapa** për tu kthyer prapa.




### 8.6. Zgjedhja e llogarisë për të kryer rimbushjen




### 8.7. Përmbledhja e transaksionit

Nëqoftëse keni kryer të gjitha veprimet e mësipërme, do ju shfaqet ekrani me përmbledhjen e transaksionit tuaj, i cili përmban detajet e numrit tuaj të telefonit së bashku me kompaninë celulare

dhe shumën e rimbushur. Nëse dëshironi të anulloni transaksionin klikoni mbi butonin **"Anulo"**.




### 8.8. Pajisja me faturë

Pasi të keni konfirmuar transaksionin tuaj, në vijim do t'ju shfaqet ekrani në të cilin mund të zgjidhni nëse dëshironi të pajiseni me faturë ose jo për transaksionin që keni kryer.

- Klikoni mbi butonin 

për tu pajisur me faturë
- Klikoni mbi butonin 

për të marrë faturën elektronikisht në email-in që keni të regjistruar në llogarinë tuaj në BKT.
- Klikoni mbi butonin 

nëse nuk dëshironi të pajiseni as me faturë fizike as me faturë elektronike.




### 8.9. Konfirmimi i Transaksionit

Në ekran-in e ATM-së do të shfaqet mesazhi se ***Transaksioni u krye me sukses***.



## 9. HISTORIKU I TRANSAKSIONEVE

Ju mund të kontrolloni historikun e transaksioneve për një periudhë specifike të përcaktuar nga ju, të të gjitha llogarive si dhe ta dërgoni atë në adresën tuaj email në çdo moment.

### 9.1. Aksesimi i menusë së historikut të transaksioneve

Për të kontrolluar historikun e transaksioneve në Smart BanKomaT, ju duhet të aksesoni menunë Më shumë dhe të klikoni në butonin Historiku i Transaksioneve.






## 9.2. Zgjedhja e llogarisë së historikut të transaksioneve

Zgjidhni një nga llogaritë e shfaqura në ekranin tuaj për të parë transaksionet.



## 9.3. Zgjedhja e e intervalit kohor të dëshiruar

Në hapin vijues do ju shfaqet mundësia për të zgjedhur intervalin kohor të dëshiruar.

Klikoni mbi ikonën e **kalendarit** për të zgjedhur intervalin e dëshiruar të historikut të transaksioneve.




## 9.4. Dërgesa e transaksionit në adresën e Email

Në këtë hap ju mund të zgjidhni periudhën që ju dëshironi për historikun e transaksioneve.

Klikoni mbi datën e fillimit dhe mbarimit të historikut të transaksioneve ose klikoni mbi periudhat ekzakte të predefinuara në të majtë dhe më pas në butonin **Dërgoni me Email** për të marrë historikun e transaksioneve në adresën tuaj të Email. Klikoni në butonin **Mbyll** për të mbyllur kalendarin që shfaqet.




## 10.LLOGARITË E MIA

Nga Smart BanKomaT-et e BKT-së ju mund të merrni informacion dhe për llogaritë tuaja në BKT mjafton të klikoni në menunë **"Llogaritë e mia"** e cila gjendet në menunë "Më Shumë" që ndodhet në ekranin kryesor të ATM-së

### 10.1. Aksesimi i menusë Llogaritë e mia

Për të aksesuar menunë Llogaritë e mia ndiqni hapat si më poshtë.

Fillimisht klikoni në menunë "Më Shumë" që ndodhet në ekranin kryesor të ATM-së.


v.4.3.0.20
Mirësevini
TI MUND TË KONTROLLO
TËNDE SHUMË THJESHT
Klikoni këtu për të aksesuar menunë **"Më shumë"**
ALL
EUR
ALL 5,000
ALL 2,000
ALL 10,000
Tërhiq Shpejt
ALL 1,000
ALL 40,000
ALL TJETËR
Zgjidhni Shumën dhe klikoni Tërhiq Shpejt
Tërheqje
Sa gjendje kam?
Më shumë
Depozitime
Kartat e kreditit
Limiti ditor i mbetur për Tërheqje: 75000 Lekë / ekuivalent në Euro
Limiti ditor i mbetur për Depozitim: 950000 Lekë ose 5000 Euro
Kthe Kartën
Data e Fundit e Hyrjes 17.12.2025, 02:17 PM
Shërbimi ndaj klientit +355 4 22 66 288


v.4.3.0.20a
Mirësevini [redacted]
Zgjidhni një nga menutë duke klikuar mbi të
Rimbushje Celulari
Përditësoni Profilin
Ndryshim PIN
Llogaritë e Mia
Historiku i Transaksioneve
Klikoni këtu për të aksesuar menunë **"Llogaritë e Mia"**
Kthe Kartën
Prapa

### 10.2. Lista e llogarive

Pasi të keni aksesuar menunë "Llogaritë e mia" lista e llogarive tuaja në BKT do të shfaqet:




### 10.3. Dërgo me E-mail

Nëse ju klikoni në butonin ***Shfaq,*** informacion rreth llogarisë tuaj do të shfaqet në ekran.



## 11.PAGESAT E SHËRBIMEVE UTILITARE (UJË DHE ENERGJI ELEKTRIKE)

Ju mund të kryeni shpejtë dhe thjeshtë pagesat e faturave të shërbimeve utilitare (energji elektrike dhe ujë) në çdo moment.

### 11.1. Aksesimi i menusë Hamburger

Për të filluar procesin e pagesës, ju duhet të logoheni me kartë debiti/krediti dhe zgjidhni **"Pagesa"**. Për të aksesuar menunë "Pagesa" ju duhet fillimisht të klikoni mbi menunë fushën e "Menu-së Hamburger" , e ndodhur në këndin e sipërm djathtas të menusë kryesore.



### 11.2. Aksesimi i menusë së Pagesave




### 11.3. Zgjedhja e kategorisë së pagesës

Në ekranin pasardhës, zgjidhni Kategorinë e pagesës nga opsionet e disponueshme **Elektricitet** për të paguar faturat e energjisë elektrike ose **Ujësjellës** për të paguar faturat e ujit**.**



### 11.4. Zgjedhja e institucionit

Në këtë hap ju mund të zgjidhni institucionin për të cilin dëshironi të bëhët pagesa nga lista e instucioneve që do ju shfaqen në ekranin e Smart BanKomaT. Në këtë hap do ju shfaqen dhe butonat Prapa për t'u kther pas dhe butonin Vazhdo për të vazhduar në ekranin pasardhës.

Për shembull, nëse ju zgjidhni kategorinë Ujësjellës do t'ju shfaqen institucionet si në vijim.




### 11.5. Zgjedhja e faturës për të paguar

Në këte hap do ju shfaqet fusha "Numri i Klientit" ku ju mund të kërkoni për faturën që dëshironi të paguani. Kërkoni për faturat e papaguara duke vendosur numrin/kodin e klientit.

Vendosni numrine klientit manualisht nga tastiera numerike në fushën




dhe në ekranin pasardhës zgjidhni një nga faturat e shfaqura në ekran që dëshironi të paguani. Navigoni në faturat e papaguara duke shtypur butonin e shfaqur në ekran.






### 11.6. Zgjedhja e llogarisë për të kryer pagesën

Në këtë ekran zgjidhni llogarinë tuaj nga e cila dëshironi të kryeni pagesën e faturës (nëse keni vetëm një llogari atëhere klikoni mbi të).




### 11.7. Përmbledhja e transaksionit

Në hapin e rradhës do ju shfaqet imazhi i cili përmban:

1. Përmbledhje të transaksionit
2. Butonin   për të konfirmuar sasinë e kartëmonedhave të depozituara.
3. Butonin   për të anuluar veprimin.




## 11.8. Pajisja me faturë

Pasi të keni konfirmuar transaksionin tuaj, në vijim do t'ju shfaqet ekrani në të cilin mund të zgjidhni nëse dëshironi të pajiseni me faturë ose jo për transaksionin që keni kryer.

- Klikoni mbi butonin 

për tu pajisur me faturë
- Klikoni mbi butonin 

për të marrë faturën elektronikisht në email-in që keni të regjistruar në llogarinë tuaj në BKT.
- Klikoni mbi butonin 

nëse nuk dëshironi të pajiseni as me faturë fizike as me faturë elektronike




## 12. PAGESA EDUKIMI

Së bashku me Pagesat e Shërbimeve Utilitare, ju mund të paguani dhe shpenzimet ose tarifat e arsimit, nëpërmjet Smart BanKomaT, pa qenë nevoja të vizitoni një degë.

### 12.1. Aksesimi i menusë Hamburger

Për të filluar procesin e pagesës, ju duhet të logoheni me kartë debiti/krediti dhe zgjidhni nga menuja kryesore ne ATM fushën e "Menu-së Hamburger" , e ndodhur në këndin e sipërm djathtas të ekranit.




## 12.2. Aksesimi i menusë së pagesave



### 12.3. Zgjedhja e kategorisë së pagesës

Në ekranin pasardhës, zgjidhni Kategorinë e pagesës: **Edukimi** nga opsionet e disponueshme:




Në ekranin në vazhdim duhet të specifikoni nëse pagesa do të bëhet në një institucion publik apo privat. Nëse ju zgjidhni “Të gjithë Universitetet” do t’ju renditen të gjitha universtetet. Zgjidhni institucionin ku do të bëhet pagesa duke naviguar në ekranin e ATM-së.



### 12.4. Zgjedhja e institucionit




### 12.5. Zgjedhja e shërbimit

Në këtë ekran ju mund të zgjidhni llojin e shërbimit për të cilin doni të kryueni pagesën si: **Tarifë arsimi, tarifë regjistrimi, tarifë aplikimi, tarifa e kartonit të diplomës** etj. Emri i shërbimit dhe numri përkatës i llogarisë do të shfaqen në ekran.



### 12.6. Detajet e pagesës

Vendosni detajet e pagesës në këtë ekran si: **Numri i identifikimit të studentit, Emri i studentit, Numri i faturës dhe Data e faturimit**. Zgjidhni datën e faturës nga kalendari i shfaqur në ekran.




### 12.7. Zgjedhja e shumës për të paguar

Zgjidhni llogarinë nga e cila dëshironi të kryeni pagesën dhe vendosni nga tastiera numerike shumën për të cilën dëshironi të kryeni pagesën.

Klikoni butonin 

për tu kthyer prapa ose butonin "Vazhdo" i cili do të bëhet i klikueshëm pasi ju të keni vendosur shumën për të paguar.




### 12.8. Përmbledhja e transaksionit

Pasi të keni vendosur shumën që dëshironi të paguani, do ju shfaqet ky imazh i cili përmban:

1. Përmbledhje të transaksionit tuaj
2. Butonin 

për të konfirmuar detajet e transaksionit të kryer
3. Butonin 

për të anuluar veprimin.



## 13. TRANSFERTË E BRENDSHME NËPËRMJET CIF/NUMRIT TË LLOGARISË/NUMRIT TË CELULARIT

Në këtë menu ju do të keni mundësi të transferoni fonde nga llogaria juaj drejt një llogarie të një klienti BKT shumë thjeshtë.

### 13.1. Aksesimi i menusë për Transferta brenda BKT

Për të filluar procesin e pagesës, ju duhet të logoheni me kartë debiti/krediti dhe zgjidhni nga menuja kryesore ne ATM fushën e “Menu-së Hamburger” , e ndodhur në këndin e sipërm djathtas të ekranit.



## 13.2. Aksesimi i menusë së transfertave




## 13.3. Përzgjedhja e llogarisë nga ku do të kalojnë fondet



### 13.4. Vendosja e shumës së Transfertës

Pasi zgjedh logarinë nga e cila do të bëhet transferimi i shumes duhet të vendosni dhe shumën e dëshiruar për të transferuar. Klienti mund të zgjedh një nga shumat e pre-definuara ose të vendosi manualisht nga tastiera një shumë tjetër.




### 13.5. Vendosja e të dhënave për përfituesin

Pasi keni plotësuar shumën e transfertës në ekranin në vazhdim, vendosni informacionin e përfituesit, i cili përfshin ose CIF /Numrin e llogarisë të klientit në BKT ose numrin e telefonit celular të klientit.




## 13.6. Përmbledhja e Transaksionit

Pasi të keni vendosur të dhënat e përfituesit duhet të konfirmoni të dhënat e transaksionit. Klikoni mbi **"Konfirmo"** për të konfirmuar transaksionin ose **"Anullo"** për ta anulluar atë.



## 13.7. Pajisja me faturë

Pasi të keni konfirmuar transaksionin tuaj, në vijim do t'ju shfaqet ekrani në të cilin mund të zgjidhni nëse dëshironi të pajiseni me faturë ose jo për transaksionin që keni kryer.

- Klikoni mbi butonin 

për tu pajisur me faturë

- Klikoni mbi butonin 

për të marrë faturën elektronikisht në email-in që keni të regjistruar në llogarinë tuaj në BKT.

- Klikoni mbi butonin 

nëse nuk dëshironi të pajiseni as me faturë fizike as me faturë elektronike



## 13.8. Konfirmimi i Transaksionit




# IV. AKSESIMI NË SMART BANKOMAT PËR JO KLIENTËT E BKT-SË

## 1. IDENTIFIKIMI ME KARTË DEBITI OSE KREDITI TË JO BKT-SË

Për të aksesuar Smart BanKomaT si jo klient i BKT-së nevojitet të posedoni:

a. *Kartë Debiti ose Krediti* (një mjet plastik në formë drejtkëndore të lëshuar nga çdo institucion financiar i cili i nënshtrohet te gjitha kushteve për t'u përdorur në bankomatet e BKT-së, unik për çdo klient, për të cilën kryhet një aplikim dhe posedohet fizikisht).

b. *PIN-in e Kartës tuaj* (një numër 4 shifror që merret nëpërmjet një zarfi ose SMS në momentin që aplikohet dhe merret një kartë debiti ose krediti).

Pasi ju fusni kartën në pajisjen kartëlexuese të bankomatit, ju shfaqet ekrani i cili ju përshëndet dhe ju fton të vendosni PIN-in e kartës nëpërmjet tastierës numerike.

Në këtë ekran ju keni mundësi të ndryshoni gjuhën e shërbimit të Smart BanKomaT duke klikuar mbi butonin që tregon gjuhën aktuale.




## 2. MENU KRYESORE

### 2.1 Hapësira fillestare

1. Njoftimi i mirëseardhjes
2. Hapësira informuese për produktet dhe shërbimet e BKT-së

### 2.2 Tërheqje e shpejtë

1. Butoni  për të zgjedhur valutën në ALL-LEK për tërheqjen e shpejtë
2. Butoni  për të zgjedhur valutën në EUR për tërheqjen e shpejtë
3. Shumat standarte të predefinuara 
4. Butoni  për të vendosur një shumë tjetër
5. Butoni  për të Tërhequr paratë menjëherë pasi keni zgjedhur shumën fillimisht

## 2.3 Transaksionet

1. Butoni Tërheqje për të vijuar me Tërheqjen e parave
2. Butoni Ndryshim PIN për të vijuar me Ndryshimin e PIN-it
3. Butoni Balanca për të kontrolluar Balancën e llogarisë tuaj
4. Butoni Zhbllokoni PIN për të zhbllokuar PIN-in e kartës tuaj

## 2.4 Hapësira fundore

1. Butoni Kthe Kartën për të marrë kartën
2. Shërbimi ndaj klientit 4 22 66 288 Informacion mbi numrin e kontaktit për Shërbimin ndaj klientit




Në Smart BanKomaT ju keni mundësi të tërhiqni vetëm në monedhën LEK, me anë të një kartë Debiti ose Krediti të lëshuar nga një institucion financiar i ndryshëm nga BKT. Për të kryer këtë

transaksion mjafton të ndiqni hapat si më poshtë.

# 3. TËRHEQJE

## 3.1. Aksesimi i menusë së Tërheqjes

Në menunë kryesore ju do të klikoni butonin 





## 3.2. Zgjedhja e shumës

Pasi të keni zgjedhur llogarinë tuaj, në këtë hap do t'ju shfaqet ekrani si më poshtë i cili përmban:

1. Shumat e predefinuara 

2. Butoni  për të vendosur një shumë tjetër

3. Butoni  për të tërhequr paratë tuaja pasi keni zgjedhur shumën fillimisht

Për të vazhduar me tërheqjen duhet të ndiqni hapat si më poshtë:

1. Zgjidh **Shumën** ose Kliko butonin **Tjetër**
2. Kliko **Tërhiq**




Nëse klikoni butonin TJETËR do t’ju shfaqet ekrani si më poshtë i cili përmban:

1. Butonin Anulo për të kaluar sërish në menunë kryesore

2. Fushën në të cilën ju mund të shkruani shumën që dëshironi nëpërmjet tastierës numerike

3. Butonin Vazhdo cili bëhet i klikueshëm vetëm nëse vendoset një vlerë shumëfish i **500 ALL** ose **5 EUR** në fushën përkatëse

### 3.3. Konfirmimi i transaksionit

Pasi të keni zgjedhur shumën që dëshironi të tërhiqni, në ketë hap do t’ju kërkohet të konfirmoni tërheqjen e parave dhe do t’ju shfaqet ekrani si më poshtë i cili përmban:

1. Numrin e kartës nga e cila ju po tërhiqni paratë
2. Shumën që do të tërhiqni
3. Informacioni i cili tregon se ky transaksion mund të përfshijë tarifa shtesë

Në këtë hap ju mund të klikoni:

1. Butonin Anulo për të anuluar veprimin
2. Butonin Konfirmo për të konfirmuar veprimin dhe për të vijuar në hapin tjetë




### 3.4. Pajisja me faturë

Pasi të keni konfirmuar transaksionin tuaj, në vijim do t'ju shfaqet ekrani në të cilin mund të zgjidhni nëse dëshironi të pajiseni me faturë ose jo për transaksionin që keni kryer.

- Klikoni mbi butonin Printo Faturen për tu pajisur me faturë
- Klikoni mbi butonin Dergo me Email për të marrë faturën elektronikisht në email-in që keni të regjistruar në llogarinë tuaj në BKT.

- Klikoni mbi butonin 

nëse nuk dëshironi të pajiseni as me faturë fizike as me faturë elektronike




## 4. BALANCA E LLOGARISË

Një nga transaksionet e vlefshëm për jo klientët e BKT të pajisur me një kartë aktive është **Kontrolli i Balancës**. Smart BanKomaT lejon kontrollin e balancës në ekran dhe printimin e faturës me këtë informacion. Për të kryer këtë transaksion mjafton të ndiqni hapat si më poshtë.

### 4.1. Aksesimi i menusë së balances

Në menunë kryesore ju do të klikoni butonin 

.




### 4.2. Printimi i faturës me informacionin e balancës

Pasi të keni klikuar butonin **Balanca**, në këtë hap do t'ju kërkohet të zgjidhni nëse dëshironi të pajiseni me faturë ose jo.

Klikoni mbi butonin Printo Faturen për të printuar faturën.

Klikoni butonin Jo faleminderit nëse nuk dëshironi të pajiseni me faturë.




### 4.3. Shfaqja e balancës

Në hapin e fundit do t'ju shfaqet imazhi si më poshtë, i cili përmban një përmbledhje të balancës tuaj.

Klikoni mbi butonin **OK** për të përfunduar me veprimin dhe më pas mund të tërhiqni kartën tuaj.



## 5. NDRYSHIMI I PIN-IT TË KARTËS TUAJ

Ndryshimi i PIN-it të kartës suaj lejohet të kryhet në Smart BanKomaT nga të gjitha kartat e debitit ose kreditit të lëshuara nga institucione financiare dhe që plotësojnë kushtet për të kryer veprime në të. Për të kryer këtë transaksion mjafton të ndiqni hapat si më poshtë.

### 5.1. Aksesimi i ndryshimit të PIN-it në menunë kryesore

Si fillim ju të mund të klikoni mbi butonin 

në menunë kryesore për të vijuar me procesin.



## 5.2. Vendosja dhe konfirmimi i PIN-it të ri




Në këtë hap do t'ju shfaqet ekrani si më sipër i cili ju udhëzon të ndryshoni PIN-in tuaj duke:

1. Vendosur **PIN-in e ri** menjëherë nëpërmjet tastierës numerike dhe duke klikuar butonin **ENTER.**
2. Ri-vendosur **PIN-in e ri** (njësoj si në hapin e parë), nëpërmjet tastierës numerike dhe duke klikuar butonin **ENTER.**

## 5.3. Konfirmimi i ndryshimit të PIN

Në hapin e fundit do t'ju shfaqet imazhi si më poshtë, i cili tregon se PIN-i i kartës tuaj është ndryshuar me sukses. Pas këtij hapi ju mund të tërhiqni kartën tuaj.




## 6. ZHBLLOKIM I PIN-IT TË KARTËS TUAJ

Zhbllokimi i PIN-it të kartës suaj lejohet të kryhet në Smart BanKomaT nga të gjitha kartat e debitit ose kreditit të lëshuara nga institucione të tjera financiare përvec BKT-së dhe që plotësojnë kushtet për të kryer veprime në të. Për të kryer këtë transaksion mjafton të ndiqni hapat si më poshtë.

### 6.1. Aksesimi i zhbllokimit të PIN-it në menunë kryesore

Fillimisht ju mund të klikoni mbi butonin 

në menunë kryesore për të vijuar me procesin.




### 6.2. Verifikim i PIN-it për zhbllokimin e tij

Pasi të keni aksesuar menunë e Zhbllokimit të PIN-it ju, në hapin vijues do ju shfaqet fusha në të cilën do t'ju kërkohet të vendosni PIN-in e vlefshëm të kartës tuaj.

PIN-i i kartës mund të vendoset menjëherë duke shtypur butonat në tastierën numerike dhe pasi të vendosni PIN-in ju duhet të klikoni butonin Enter.




### 6.3. Konfirmimi i zhbllokimit të PIN-it

Nëse ju keni vendosur PIN-in e vlefshëm të kartës suaj, në hapin e rradhës ju do të njoftoheni për zhbllokimin e PIN-it me sukses.



# V. TRANSAKSIONE PA KARTË

Në këtë hapësirë ju do të keni mundësinë të informoheni mbi veprimet që mund të kryhen në Smart BanKomaT pa patur nevojën për të qenë i pajisur me një kartë debiti/krediti të lëshuar nga BKT. Shërbimet **Pa Kartë** ofrojnë një mënyrë të sigurt dhe praktike për të realizuar veprime bankare, si tërheqje dhe depozitim fondesh, drejtpërdrejt nga ATM-ja.

## ➢ Aksesimi i shërbimeve Pa Kartë në aplikacionin BKT Smart

Për të aksesuar shërbimet **Pa Kartë**, është e domosdoshme që pajisja celulare ku është i instaluar aplikacioni **BKT Smart** të jetë e cilësuar si **pajisje e autorizuar (pajisje e besuar)**. Kjo masë zbatohet për arsye sigurie, me qëllim mbrojtjen e transaksioneve që do të kryeni dhe të të dhënave tuaja bankare.

Vetëm në rast se pajisja juaj është e autorizuar, shërbimet **Pa Kartë** do të shfaqen dhe do të jenë të disponueshme në aplikacionin BKT Smart. Nëse këto shërbime nuk shfaqen në aplikacion, është e nevojshme të autorizoni pajisjen tuaj duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

1. Hyni në aplikacionin **BKT Smart** duke përdorur kredencialet tuaja.
2. Shkoni në menunë **"Profili dhe Cilësimet"**.
3. Zgjidhni seksionin **"Pajisjet e autorizuara"** dhe ndiqni hapat përkatës për autorizimin e pajisjes.

Për më shumë informacion lidhur me autorizimin e pajisjes dhe përdorimin e aplikacionit, referojuni **Manualit të përdorimit të aplikacionit BKT Smart** në faqen zyrtare të BKT-së: Manuale Përdorimi | Banka Kombetare Tregtare.

Të gjitha veprimet dhe shërbimet që mund të kryhen pa kartë përshkruhen në seksionet vijuese të këtij manuali. Ndiqni hapat përkatës për të realizuar transaksionet tuaja në mënyrë të thjeshtë dhe të sigurt.




## 1. TËRHEQJE ME KOD UNIK

Tërheqja me Kod Unik mund të përdoret në rastet kur ju dëshironi të tërhiqni para nga Smart BanKomatëT e BKT-së pa patur nevojën e përdorimit të kartës suaj.

Për të kryer tërheqjen me Kod Unik, transaksioni ndahet në dy faza:

1. Gjenerimi i Kodit Unik në aplikacionin BKT Smart
2. Tërheqja e parave në Smart BanKomaT

### 1.1. Gjenerimi i Kodit Unik në aplikacionin BKT Smart

#### 1.1.1. Aksesimi i menusë së Tërheqjes pa kartë

Tërheqja me Kod Unik mund të kryhet vetëm nga një klient i BKT-së dhe duhet të inicohet në aplikacionin BKT Smart në menunë "Pa Kartë" → "Tërheqje me Kod Unik"

Për të inicuar transaksionin nga BKT Smart ndiqni hapat si më poshtë:

1. Hyni në **BKT Smart** nga telefoni juaj celular
2. Klikoni mbi ***"Pagesat & Transfertat"***

3. Zgjidhni ***opsionin "Pa Kartë"*** dhe ***"Tërheqje me Kod Unik".***
4. Në menunë që ju shfaqet klikoni në butonin **"Tërheqje e re pa kartë"**




### 1.1.2. Zgjedhja e llogarisë dhe përcaktimi i shumës së tërheqjes

Në hapin e rradhës duhet të zgjidhni llogarinë nga e cila do të tërhiqni paratë duke ndjekur hapat në vijim.

1. Zgjidhni llogarinë nga e cila do të tërhiqni paratë
2. Zgjidhni shumën e tërheqjes nga 1,000 – 10,000 Lekë duke përdorur opsionin "Shuma e përcaktuar" ose "Shumë Tjetër".
3. Vlefshmërine e Kodit Unik nga 1 – 72 orë.
4. Mundësine e përdorimit të **Kodit Unik** në **të gjitha terminalet** Smart BanKomaT ose jo.




### 1.1.3. Gjenerimi i mesazhit të konfirmimit

Pasi të keni klikuar mbi butonin **Vazhdoni** do të gjenerohet kodi Unik, i cili do të shërbejë për të tëhequr paratë në Smart BanKomaT.




## 1.2. Tërheqja e parave në Smart BanKomaT

Ju mund të kryeni transaksione pa kartë në çdo Smart BanKomaT. Klikoni mbi butonin, 

të cilën e gjeni në faqen mirëseardhëse të bankomatit.



### 1.2.1. Tërheqje me Kod Unik

Në menunë që do t'ju shfaqet klikoni Tërheqje me Kod Unik.




### 1.2.2. Validimi i Kodit Unik

Në fushën Shuma [0,00] vendosni Shumën dhe në fushën Kodi Unik [****] Kodin Unik nëpërmjet tastierës numerike, të cilat janë gjeneruar nga aplikacioni BKT Smart. Pasi të keni vendosur të dhënat e sakta, klikoni butonin Konfirmo për të vijuar më tej me tërheqjen.

Ju gjithashtu mund të klikoni mbi:

1. Menu Kryesore për të aksesuar menunë kryesore
2. Butonin Prapa për tu kthyer pas

Nëse Kodi Unik dhe shuma që keni vendosur përputhet me shumën e vendosur në BKT Smart dhe kodin e gjeneruar nga BKT Smart ju do të keni mundësi të vazhdoni me hapin e rradhës.




### 1.2.3. Konfirmimi i Transaksionit



### 1.2.4. Pajisja me faturë

Pasi të keni konfirmuar transaksionin tuaj, në vijim do t'ju shfaqet ekrani në të cilin mund të zgjidhni nëse dëshironi të pajiseni me faturë ose jo për transaksionin që keni kryer.

- Klikoni mbi butonin 

për tu pajisur me faturë

- Klikoni mbi butonin 

nëse nuk dëshironi të pajiseni as me faturë fizike as me faturë elektronike




## 2. TËRHEQJE ME KOD QR

Njësoj si Tërheqja me Kod Unik dhe Tërheqja me Kod QR mund të përdoret në rastet kur ju dëshironi të tërhiqni para nga Smart BanKomatëT e BKT-së pa patur nevojën e përdorimit të kartës suaj.

Për të kryer tërheqjen me Kod QR, transaksioni ndahet në dy faza:

1. Inicimi i transaksionit në aplikacionin BKT Smart
2. Tërheqja e parave në Smart BanKomaT

## 1.1. Inicimi i transaksionit në aplikacionin BKT Smart

### 1.1.1. Aksesimi i menusë së Tërheqjes pa kartë

Tërheqja me Kod QR mund të kryhet vetëm nga një klient i BKT-së dhe duhet të inicohet në aplikacionin BKT Smart në menunë "Pa Kartë" → "Tërheqje me QR"

Për të inicuar transaksionin nga BKT Smart ndiqni hapat si më poshtë:

1. Hyni në **BKT Smart** nga telefoni juaj celular
2. Klikoni mbi ***"Pagesat & Transfertat"***
3. Zgjidhni ***opsionin "Pa Kartë"*** dhe ***"Tërheqje me QR".***




### 1.1.2. Zgjedhja e llogarisë dhe përcaktimi i shumës së tërheqjes

Në hapin e rradhës duhet të zgjidhni llogarinë nga e cila do të tërhiqni paratë duke ndjekur hapat në vijim.

1. Zgjidhni llogarinë nga e cila do të tërhiqni paratë
2. Zgjidhni shumën e tërheqjes duke filluar nga 1,000 deri në 75,000 Lekë duke përdorur opsionin "Shuma e përcaktuar" ose "Shumë Tjetër".
3. Klikoni "Vazhdoni" për të vijuar me hapin e rradhës.




### 1.1.3. Skanimi i Kodit QR në ATM

Pasi të keni klikuar mbi butonin **Vazhdoni** do të hapet kamera e telefonit tuaj e cila do t'ju jap mundësinë të skanoni kodin QR që ndodhet në ATM.
Ndiqni hapat në kapitullin 2.2 për të shfaqur kodin QR në ATM

## 1.2. Tërheqja e parave në Smart BanKomaT

Për të tërhequr paratë me kod QR siç ilustrohet dhe më siper transaksioni duhet të vijojë në Smart BanKomaT. Ju mund të kryeni transaksione pa kartë në çdo Smart BanKomaT.
Për të tërhequr para me kod QR në ATM ka dy mënyra.
1. Skanimi i Kodit QR direkt nga ekrani kryesor i ATM-së – "Touchless QR"
2. Skanimi i Kodit QR nga menuja "Transaksione pa Kartë" 

të cilën e gjeni në ekranin kryesor të ATM-së.




Në rast se kryeni transaksionin duke ndjekur **Mënyren 2**, pra nga menu-ja e **Transaksioneve pa Kartë**, pasi keni klikuar në menunë "Transaksione me Kod QR" do t'ju shfaqet ekrani që përmban kodin QR të cilin duhet ta skanoni për të vijuar me depozitimin e parave. Poziciononi aparatin tuaj celular tek kodi QR në ekranin e ATM-së për ta skanuar atë.



### 1.2.1. Përmbledhja e transaksionit

Pasi të keni skanuar kodin QR do t'ju shfaqet ekrani me informacionin lidhur me tërheqjen që keni kryer Në këtë hap ju keni mundësinë të:

1. Konfirmoni transaksionin duke klikuar mbi butonin **"Konfirmo".**
2. Të anuloni transaksionin duke klikuar mbi butonin **"Anulo"**. Nëse ju anuloni transaksionin, kartëmondedhat që keni depozituar do t'ju kthehen mbrapsht.




### 1.2.2. Pajisja me faturë

Pasi të keni konfirmuar transaksionin tuaj, në vijim do t'ju shfaqet ekrani në të cilin mund të zgjidhni nëse dëshironi të pajiseni me faturë ose jo për transaksionin që keni kryer.

- Klikoni mbi butonin 

për tu pajisur me faturë

- Klikoni mbi butonin 

nëse nuk dëshironi të pajiseni as me faturë fizike as me faturë elektronike




### 1.2.3. Konfirmimi i Transaksionit

Në hapin e fundit do t'ju shfaqet imazhi si më poshtë, i cili tregon se transaksioni është kryer me sukses.



## 3. DEPOZITIMI ME KOD QR

Depozitimi me Kod QR është i nevojshëm të përdoret në rastet kur ju dëshironi të tërhiqni para nga Smart BanKomatëT e BKT-së pa patur nevojën e përdorimit të kartës suaj.
Për të kryer tërheqjen me Kod QR, transaksioni ndahet në dy faza:

1. Inicimi i transaksionit në aplikacionin BKT Smart
2. Tërheqja e parave në Smart BanKomaT

### 3.1. Inicimi i transaksionit në aplikacionin BKT Smart

#### 3.1.1. Aksesimi i menusë së Tërheqjes pa kartë

Depozitimi me Kod QR mund të kryhet vetëm nga një klient i BKT-së dhe duhet të inicohet në aplikacionin BKT Smart në menunë "Pa Kartë" → "Depozitim me QR"
Për të inicuar transaksionin nga BKT Smart ndiqni hapat si më poshtë:

1. Hyni në **BKT Smart** nga telefoni juaj celular
2. Klikoni mbi ***"Pagesat & Transfertat"***
3. Zgjidhni ***opsionin "Pa Kartë"*** dhe ***"Depozitim me QR".***



### 3.1.2. Zgjedhja e llogarisë ku do të kryhet depozitimi

Në hapin e rradhës duhet të zgjidhni llogarinë në të cilën do të kryeni depozitimin e parave duke ndjekur hapat në vijim.

1. Zgjidhni llogarinë tek e cila do të depozitoni paratë
2. Klikoni "Vazhdoni" për të vijuar me hapin e rradhës.




### 3.1.3. Skanimi i Kodit QR në ATM

Pasi të keni klikuar mbi butonin **Vazhdoni** do të hapet kamera e telefonit tuaj e cila do t'ju jap mundësinë të skanoni kodin QR që ndodhet në ATM.

Ndiqni hapat në kapitullin 2.2 për të shfaqur kodin QR në ATM

### 3.2. Depozitimi i parave në Smart BanKomaT

Për të depozituar paratë me kod QR sic ilustrohet dhe më siper transaksioni duhet të vijojë në Smart BanKomaT. Ju mund të kryeni transaksione pa kartë në çdo Smart BanKomaT.

Për të depozituar para me kod QR në ATM keni dy mundësi.

1. Skanimi i Kodit QR direkt nga ekrani kryesor i ATM-së – "Touchless QR"
2. Skanimi i Kodit QR nga menuja "Transaksione pa Kartë" Transaksione pa Kartë të cilën e gjeni në ekranin kryesor të ATM-së.




Në rast se kryeni transaksionin duke ndjekur **Mënyren 2**, pra nga menu-ja e **Transaksioneve pa Kartë**, pasi keni klikuar në menunë "Transaksione me Kod QR" do t'ju shfaqet ekrani që përmban kodin QR të cilin duhet ta skanoni për të vijuar me depozitimin e parave. Poziciononi aparatin tuaj celular tek kodi QR në ekranin e ATM-së për ta skanuar atë.




### 3.2.1. Depozitimi i parave

Pasi të keni skanuar kodin QR në hapin në vazhdim do t'ju duhet të vendosni paratë në hapësirën e depozitimit në Smart BanKomaT për të kryer depozitimin e parave tuaja.
Klikoni në butonin **"Anulo"** për të anulluar transaksionin.

### 3.2.2. Përmbledhja e transaksionit

Pas depozimit të parave do t'ju shfaqet ekrani me informacionin lidhur me depozitimin që keni kryer si shuma e depozituar dhe kartëmonedhat e depozituara. Në këtë hap ju keni mundësinë të:

1. Konfirmoni transaksionin duke klikuar mbi butonin **"Konfirmo".**
2. Të shtoni kartëmonedha duke klikuar mbi butonin **"Shto".**
3. Të anuloni transaksionin duke klikuar mbi butonin **"Anulo"**. Nëse ju anulloni transaksionin, kartëmondedhat që keni depozituar do t'ju kthehen mbrapsht.




### 3.2.3. Pajisja me faturë

Pasi të keni konfirmuar transaksionin tuaj, në vijim do t'ju shfaqet ekrani në të cilin mund të zgjidhni nëse dëshironi të pajiseni me faturë ose jo për transaksionin që keni kryer.

- Klikoni mbi butonin 

 për tu pajisur me faturë
- Klikoni mbi butonin 

 nëse nuk dëshironi të pajiseni as me faturë fizike as me faturë elektronike




### 3.2.4. Konfirmimi i Transaksionit

Në hapin e fundit do t'ju shfaqet imazhi si më poshtë, i cili tregon se transaksioni është kryer me sukses.



## 4. RIMBUSHJE CELULARI PA KARTË

Ju mund të rimbushni numrin tuaj të celularit pa qenë i pajisur me një kartë.

Për të kryer këtë transaksion klikoni në menunë **Transaksione pa Kartë**




### 4.1. Aksesimi i menusë së Rimbushjes së Celularit pa kartë

Klikoni në butonin **Rimbushje Celulari** për të proceduar me rimbushjen e telefonit ose mbi butonin për **Menu Kryesore** tu kthyer në menunë kryesore.



### 4.2. Zgjedhja e operatorit celular

Në këtë hap ju do të keni mundësinë të zgjidhni një nga kompanitë celulare. Selektoni kompaninë tuaj celulare dhe vijoni me procesin e rimbushjes ose Prapa klikoni butonin për tu kthyer pas.




### 4.3. Vendosja e Numrit Celular

Pasi të keni zgjedhur operatorin ju shfaqet ekrani si më poshtë i cili përmban:

1. Fushën **Numri Celular** për të shkruar numrin tuaj në formatin +3556xxxxxxxx
2. Butonin Prapa për tu kthyer prapa
3. Butonin Vazhdo për të vazhduar më tej me procesin e rimbushjes
4. Fusha Numri Celular +355 ku ju mund të vendosni numrin nga tastiera numerike në BanKomaT e numrit celularit që ju doni të rimbushni




### 4.4. Depozitimi i kartëmonedhave

Pasi të keni vendosur numrin, do t'ju kërkohet të depozitoni kartëmonedhat në hapësirën përkatëse në bankomat të cilat do të shërbejnë për rimbushje.

Ky transaksion kryhet vetëm në monedhën LEKË.

Vlera e rimbushjes do të jetë e barabartë me vlerën e kartëmonedhave të depozituara.




## 4.5. Përmbledhja e transaksionit

Pas depozimit të parave do t'ju shfaqet ekrani me informacionin lidhur me depozitimin që keni kryer si shuma e depozituar dhe kartëmonedhat e depozituara. Në këtë hap ju keni mundësinë të:

1. Konfirmoni transaksionin duke klikuar mbi butonin Konfirmo.
2. Të shtoni kartëmonedha duke klikuar mbi butonin Shto.
3. Të anuloni transaksionin duke klikuar mbi butonin Anulo. Nëse ju anulloni transaksionin, kartëmondedhat që keni depozituar do t'ju kthehen mbrapsht.




## 4.6. Rimbushja dhe zgjedhja e paketës

Në këtë hap ju do të keni mundësinë të zgjidhni nëse dëshironi vetëm të rimbushni numrin tuaj ose të zgjidhni të aktivizoni një paketë se bashku me rimbushjen për celularin tuaj. Në ekran, do t'ju shfaqen gjithashtu paketat e ofruara nga operatori juaj celular. Klikoni mbi butonin **"Shfaq"** në paketat e shfaqura në ekran nëse dëshironi të shikoni detajet përkatëse për secilën nga paketat.



### 4.7. Përmbledhja e transaksionit

Në qoftë se keni kryer të gjitha veprimet e mësipërme, do t'ju shfaqet ekrani me përmbledhjen e transaksionit tuaj, i cili përmban detajet e numrit tuaj të telefonit së bashku me operatorin celular dhe shumën e rimbushur. Për të vazhduar më tej me rimbushjen mjafton të klikoni mbi butonin Konfirmo.




### 4.8. Pajisja me faturë

Pasi të keni konfirmuar transaksionin tuaj, në vijim do t'ju shfaqet ekrani në të cilin mund të zgjidhni nëse dëshironi të pajiseni me faturë ose jo për transaksionin që keni kryer.

- Klikoni mbi butonin Printo Faturen për tu pajisur me faturë
- Klikoni mbi butonin Jo faleminderit nëse nuk dëshironi të pajiseni as me faturë fizike as me faturë elektronike.




### 4.9. Konfirmimi i transaksionit

Nëse rimbushja juaj është gjeneruar me sukes do ju shfaqet ky mesazh konfirmimi me shumën tuaj të rimbushjes dhe paketën e aktivizuar (në rast se keni zgjedhur dhe aktivizim pakete).

Klikoni butonin Menu Kryesore për tu kthyer në menunë baze ose butonin Kthe Kartën për të tërhequr kartën tuaj.




## 5. DEPOZITIMI I PARAVE PA KARTË PËR KLIENTË BKT (NGA NJË KLIENT BKT TEK NJË KLIENT BKT)

Përveç depozitimit në llogarinë tuaj, në Smart BanKomaT ju mund të kryeni depozitime pa kartë dhe në llogarinë e një klienti tjetër BKT pa patur nevojën për të qënë i pajisur me një kartë debiti/krediti të lëshuar nga BKT.

Ndiqni hapat në vijim për të parë sesi mund të kryeni depozitime pa kartë me para kesh tek një klient tjetër i BKT-së ne Smart BanKomaT.

### 5.1. Aksesimi i menusë së depozitimit pa kartë

Klikoni në butonin 

, të cilin e gjeni në faqen mirëseardhëse të çdo Smart BanKomaT për të aksesuar menunë “Transaksione pa Kartë”.




## 5.2. Aksesimi i menusë së depozitimit për klient të BKT

Pasi të keni klikuar në menunë "Transaksione pa Kartë" ekrani në vazhdim do t'ju shfaqet, ku ju duhet të zgjidhni menunë **"Transferta Parash"**.



### 5.3. Vendosja e të dhënave tuaja (iniciuesit të veprimit)

Pasi të keni klikuar në menunë **"Transferta Parash"** në ekranin në vazhdim ju duhët të plotësoni të dhënat tuaja në mënyrë që të kryhet identifikimi i iniciuesit të veprimit duke qënë se transaksioni po kryhet pa kartë.

Të dhënat që ju duhet të plotësoni janë:

1. Numri personal SSN që ndodhet në kartën tuaj të identitetit
2. Numrin tuaj të celularit të regjistruar në BKT.




Pasi të keni plotësuar të dhënat më sipër klikoni mbi butonin **"Konfirmo"** i cili do të bëhet i klikueshëm. Në rast se dëshironi të ktheheni në menunë Transkasione pa Kartë klikoni mbi butonin **"Anulo"**.

### 5.4. Dërgimi i Kodit 6-Shifror (FNP)

Pasi të keni plotësuar të dhënat më sipër në ekranin në vazhdim do t'ju kërkohet të vendosni një kod 6-shifror të dërguar në numrin tuaj.

Kodi një përdorim (FNP) me 6 shifra do të dërgohet në numrin tuaj celular të regjistruar në BKT.

Vendosni kodin 6-shifror duke përdorur tastierën numerike të Smart BanKomaT-it dhe më pas klikoni mbi butonin **"Vazhdo"** për të vijuar me transaksionin ose **"Anulo"** për të anuluar transaksionin tuaj.




### 5.5. Depozitimi i Parave në Smart BanKomaT

Pasi të keni vendosur kodin 6-shifror dhe butonin **"Vazhdo"** në hapin në vazhdim do t'ju duhet të vendosni paratë në hapësirën e depozitimit në Smart BanKomaT për të kryer depozitimin e parave tuaja.

Klikoni në butonin **"Anulo"** për të anulluar transaksionin.

### 5.6. Përmbledhja e transaksionit

Pas depozimit të parave do t'ju shfaqet ekrani me informacionin lidhur me depozitimin që keni kryer si shuma e depozituar dhe kartëmonedhat e depozituara. Në këtë hap ju keni mundësinë të:

1. Konfirmoni transaksionin duke klikuar mbi butonin **"Konfirmo".**
2. Të shtoni kartëmonedha duke klikuar mbi butonin **"Shto".**
3. Të anuloni transaksionin duke klikuar mbi butonin **"Anulo"**. Nëse ju anulloni transaksionin, kartëmondedhat që keni depozituar do t'ju kthehen mbrapsht.




### 5.7. Vendosja e të dhënave të përfituesit

Pasi të keni konfirmuar shumën e depozituar në hapin e rradhës ju duhet të vendosni të dhënat e përfituesit të parave të depozituara, pra personit ku do të kalojnë fondet.
Ju keni mundësinë të zgjidhni ndërmjet Numrit të Klientit në BKT ose Numrit Personal të ID-së për të identifikuar përfituesin ku do të kalojnë paratë.

Në varësi të opsionit që zgjidhni, plotësoni informacion dhe klikoni mbi butonin **"Vazhdo"** për të vijuar me transaksionin ose butonin **"Prapa"** për tu kthyer në hapin paraardhës.




### 5.8. Konfirmimi i Transaksionit

Në këtë hap në ekran do të shfaqet një përmbledhje e transaksionit tuaj. Klikoni mbi butonin "Konfirmo" për ta konfirmuar atë ose në butonin "Anulo" për ta anuluar atë.



### 5.9. Pajisja me faturë

Pasi të keni konfirmuar transaksionin tuaj, në vijim do t'ju shfaqet ekrani në të cilin mund të zgjidhni nëse dëshironi të pajiseni me faturë ose jo për transaksionin që keni kryer.

- Klikoni mbi butonin 

për tu pajisur me faturë
- Klikoni mbi butonin 

nëse nuk dëshironi të pajiseni as me faturë fizike as me faturë elektronike.




## 6. DEPOZITIM PA KARTË ME KOD UNIK PËR BIZNESET

Sikurse klienti individ i cili mund të kryej transaksione pa kartë nëpërmjet kodit QR apo Unik në Smart BanKomaT-et e BKT-së dhe klientët Biznes mund të kryejnë depozitimin e fondeve nga aktiviteti pa patur nevojën për të pasur nje kartë debiti/krediti fizike. Nëpërmjet Kodit Unik depozitimin për biznesin mund ta kryej dhe një punonjës pa qënë nevoja të paraqitet administrator apo pronari. Ndiqni hapat përkatëse për të thjeshtësuar veprimet tuaja.

Veprimi është i ndarë në dy faza:

1. Gjenerimi i kodit unik nga Dega Internet për Biznesin nga administratori i biznesit i cili duhet të jetë përdorues i Degës Internet.
2. Depozitimi i fondeve në rrjetin e ATM-ve BKT nga vet administrator apo një punonjës që ai zgjedh.

### 6.1. Gjenerimi i kodit Unik nga Dega Internet për Biznesin

Për të gjeneruar kodin unik ju duhet të hyni në Degën Internet për Bizneset me kredencialet përkatëse dhe të klikoni mbi menunë:**" Transaksione pa kartë".**






Menu-ja e **"Transksione pa kartë"** ka tre nën menu **"Depozitim me QR"**, **"Gjenero Kodin Unik"** dhe **"Lista e transaksioneve pa kartë"**.

Për të gjeneruar kodin unik klienti duhet të zgjedhi nënmenu **"Gjenero Kodin Unik"** dhe dritarja në vazhdim do të shfaqet ku ju duhet të plotësoni informacionin si në vijim:

1. Llogarine ku do të depozitohen fondet.
2. Punonjësin që do të kryejë depozitimin.
3. ATM-në ku do të depozitohen fondet.
4. Kohën e vlefshmërisë së kodit unik
5. Burimin e të ardhurave.

Për më shumë detaje lidhur me plotësimin e të dhënave më sipër vazhdoni leximin e manualit.




### 6.1.1. Përzgjedhja e llogarisë

Fillimisht ju duhet të përzgjidhni llogarinë në të cilën do të depozitohen fondet. Mbani në vëmëndje se monedha e llogarisë duhet të jetë e njëjtë me monedhën e shumës që do të depozitohet në ATM.

### 6.1.2. Plotësimi i detajeve për punonjësin

Në dritaren <u>*"Detajet e punonjësit"*</u> zgjidhni nga lista emrin e personit që do të kryejë depozitimin në ATM. Në listë do të shfaqen emrat e punonjësve të subjektit të cilët kanë përfituar pagën në BKT gjatë 2 muajve të fundit, në list do të përfshihet dhe përfaqësuesi ligjor i subjektit. Pasi të zgjidhni emrin e punonjësit/përfaqësuesit ligjor do të plotësohet automatikisht "<u>*ID e punonjësit"*</u> dhe "<u>*Numri i telefonit*</u>" (të dy fushat janë të paeditueshme dhe nuk mund të ndryshohen).



### 6.1.3. Plotësimi i detajeve për depozitimin

Në dritaren "Detajet e depozitës" zgjidhni nga lista një nga opsionet si në vazhdim.

- Zgjidhni ATM ku do të depozitoni para - klienti duhet të zgjedhi nga lista ATM-në ku do të depozitohen fondet (nëse nuk dëshiron të zgjedhi një ATM specifike mund të klikoj opsionin ALL-të gjitha ATM).
- Zgjidhni kohën e vlefshmërisë së kodit unik (në orë) - nga lista zgjidhni kohën e validimit të kodit unik. Koha minimale është 1 orë dhe maksimumi 72 orë.




Pasi të klikoni mbi butonin ***Vazhdo,*** do t'ju shfaqet një dritare përmbledhëse me të gjitha detajet e transaksionit.

Klikoni sërish mbi butonin ***Vazhdo***, nëse i konfirmoni të dhënat e shfaqura, ose klikoni **butonin X**, nëse dëshironi të modifikoni detajet ose te anulloni transaksionin.



Mesazhi i gjenerimit me sukses të kodit unik do të shfaqet si në vazhdim:




Në këtë moment në numrin celular të punonjësit që keni zgjedhur për të kryer depozitimin do të dërgohet kodi unik 6-shifror të cilin ai/ajo duhet ta përdori gjatë fazës së dytë të transaksionit: Depozitimit të parave në Smart BanKomaT.

### 6.2. Depozitimi i fondeve me Kod Unik në ATM

Punonjësi do të paraqitet në ATM ku do të depozitoj fondet e aktivitetit nga biznesi dhe klikon në menunë “Transaksione pa Kartë” 

të cilën e gjen në faqen mirëseardhëse të çdo Smart BanKomaT dhe më pas opsionin **“Depozito me Kod Unik”**.

### 6.2.1. Aksesimi i menusë së Depozitimit me Kod Unik







### 6.2.2. Vendosja e Kodit Unik

Pasi të keni klikuar në menunë "Depozito me Kod Unik" në vazhdim do të shfaqet ekrani për plotësimin e kodit unik. Punonjësi/Përfaqësuesi ligjor do të vendosi kodin unik të dërguar në numrin e tij të telefonit në ekranin e ATM-së.




### 6.2.3. Depozitimi i fondeve

Me validimin e kodit unik me sukses, vendosni kartëmonedhat që dëshironi të depozitoni në hapësirën përkatëse në ATM. Me validimin e kartëmonedhave të depozituara, në hapin pasardhës punonjësi/përfaqësuesi ligjor do të konfirmojë shumën e depozituar në ATM në ekranin përmbledhës duke klikuar mbi butonin Konfirmo .



### 6.2.4. Pajisja me faturë

Në hapin e fundit përzgjidhet nëse dëshiron të pajiset me faturë fizike ose jo. Për t'u pajisur me faturë punonjësi/përfaqësuesi ligjor klikon mbi butonin Printo Faturen Ose mbi butonin Jo faleminderit nëse nuk dëshiron të pajiset me faturë.




## 7. DEPOZITIM PA KARTË ME KOD QR PËR BIZNESET

Ashtu si klientët individë, edhe klientët Biznes të BKT-së kanë mundësinë të kryejnë depozitimin e fondeve pa përdorur kartë debiti/krediti fizike, nëpërmjet teknologjisë së Kodit QR. Ky shërbim i ri u mundëson bizneseve të depozitojnë të ardhurat e aktivitetit në llogaritë e tyre bankare në mënyrë të shpejtë dhe të sigurt, duke përdorur aplikacionin BKT Smart dhe rrjetin e Smart BanKomaT-eve të BKT-së.

Depozitimi me Kod QR për Biznesin mund të kryhet nga një punonjës i autorizuar nga administrator i biznesit, pa qenë e nevojshme paraqitja e administratorit apo pronarit të subjektit në ATM.

Veprimi realizohet në dy faza:

1. Aktivizimi i shërbimit dhe konfigurimi i punonjësit, i kryer nga administratori i biznesit në Degën Internet për Biznes.
2. Depozitimi i fondeve në ATM, i kryer nga punonjësi i autorizuar nëpërmjet aplikacionit BKT

Smart dhe Kodit QR.

### 7.1. Aktivizimi i shërbimit dhe konfigurimi i punonjësit nga Dega Internet

Për të aktivizuar shërbimin e depozitimit me Kod QR për Biznesin, administratori i subjektit duhet të jetë përdorues i Degës Internet për Biznes dhe të ndjekë hapat e mëposhtëm:

1. Hyni në Degën Internet për Biznes me kredencialet përkatëse.




2. Pasi të keni hyrë, nga menuja kryesore, klikoni mbi "Transaksione pa Kartë" dhe më pas zgjidhni nënmenunë "Depozitim me QR".




3. Klikoni mbi butonin *"Shto konfigurim të ri"*.




Në dritaren që shfaqet, plotësoni të dhënat si më poshtë:

- Zgjidhni **llogarinë bankare** ku do të depozitohen fondet. Llogaria mund të jetë në Lekë (ALL) ose Euro (EUR). Monedha e llogarisë duhet të përputhet me monedhën e shumës që do të depozitohet në ATM.
- Nga lista përkatëse, zgjidhni **punonjësin** që do të kryejë depozitimin në ATM. Në momentin

que zgjidhni punonjësin të dhënat e tij (SSN dhe numri i celularit) do të plotësohen automatikisht.

- Zgjidhni **burimin e të ardhurave** që po depozitohen.




Pas përzgjedhjes së të dhënave, klikoni mbi butonin **"Vazhdo"**.

4. Verifikoni me kujdes të gjitha detajet e shfaqura në ekranin përmbledhës dhe klikoni mbi butonin "Konfirmo".




Pas konfirmimit, konfigurimi do të kryhet me sukses dhe do të shfaqet mesazhi përkatës i suksesit.




Për të identifikuar vizualisht kompaninë ju mund të zgjidhni një ikonë nga opsionet e disponueshme ose të ngarkoni imazhin që dëshironi dhe më pas kliko **Konfirmo**. Ikona/Imazhi i zgjedhur do ti shfaqet punonjësit në BKT Smart.






### 7.2. Depozitimi i fondeve me Kod QR në ATM

Pas përfundimit të konfigurimit nga administratori, punonjësi i autorizuar mund të kryejë depozitimin e fondeve duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

#### 7.2.1. Inicimi i transaksionit në aplikacionin BKT Smart

Depozitimi me Kod QR për biznesin mund të kryhet vetëm nga punonjësi i autorizuar dhe duhet të inicohet në aplikacionin BKT Smart sipas hapave më poshtë:

1. Hapni aplikacionin **BKT Smart** nga telefoni juaj celular dhe më faqen hyrëse kliko mbi menunë **"Pa kartë"**




2. Kliko mbi opsionin **"Depozito me QR kod për biznes"**




3. Zgjidh llogarinë ku do të depozitohen fondet, sipas konfigurimit të kryer nga administratori.




Pasi të keni përzgjedhur llogarinë do të hapet kamera e telefonit tuaj e cila do t’ju jap mundësinë të skanoni kodin QR që ndodhet në ATM.



### 7.2.2. Procesi i Depozitimit në ATM

#### 1. Skanimi i Kodit QR

Për të skanuar kodin QR në ATM ofrohen dy mundësi:

- Skanimi i Kodit QR direkt nga ekrani kryesor i ATM-së
- Skanimi i Kodit QR nga menuja “Transaksione pa Kartë” Transaksione pa Kartë të cilën e gjeni në ekranin kryesor të ATM-së.




Në rast se kryeni transaksionin duke ndjekur **Mënyren 2**, pra nga menu-ja e **Transaksioneve pa Kartë**, pasi keni klikuar në menunë “Transaksione me Kod QR” do t’ju shfaqet ekrani që përmban kodin QR të cilin duhet ta skanoni për të vijuar me depozitimin e parave. Poziciononi aparatin tuaj celular tek kodi QR në ekranin e ATM-së për ta skanuar atë.




2. **Depozitimi**

Pasi të keni skanuar kodin QR në hapin në vazhdim do t'ju duhet të vendosni paratë në hapësirën e depozitimit në Smart BanKomaT për të kryer depozitimin e parave tuaja.

Klikoni në butonin **"Anulo"** për të anulluar transaksionin.



Pas depozimit të parave do t'ju shfaqet ekrani me informacionin lidhur me depozitimin që keni kryer si shuma e depozituar dhe kartëmonedhat e depozituara. Në këtë hap ju keni mundësinë të:

1. Konfirmoni transaksionin duke klikuar mbi butonin **"Konfirmo".**
2. Të shtoni kartëmonedha duke klikuar mbi butonin **"Shto".**
3. Të anuloni transaksionin duke klikuar mbi butonin **"Anulo"**. Nëse ju anulloni transaksionin, kartëmondedhat që keni depozituar do t'ju kthehen mbrapsht.




### 3. Përfundimi i transaksionit

Pasi të keni konfirmuar transaksionin, ju do të pajisen me një faturë fizike e cila tregon detajet e depozitimit.

Në hapin e fundit do t'ju shfaqet imazhi si më poshtë, i cili tregon se transaksioni është kryer me sukses.




## 8. KURSI I KËMBIMIT

Ju mund të shikoni në kohë reale kursin e këmbimit në Smart BanKomaT duke klikuar mbi butonin “Transaksione pa Kartë” në menunë kryesore.

### 8.1. Aksesimi i menusë së Kursit të Këmbimit

Në mënyrë që të shikoni kursin e këmbimit nga Smart BanKomaT-et e BKT-së fillimisht ju duhet të shkoni në menunë “Transaksione pa Kartë”. Më pas në ekranin që do t’ju shfaqet klikoni në menunë **“Kursi i Këmbimit”.**




### 8.2. Përmbledhja e kursit të këmbimit

Pasi të keni klikuar në menunë "Kursi i Këmbimit" do të shfaqet ekrani në vazhdim që përmban informacion për kursin e këmbimit për shitje dhe blerje për disa monedha.




## VI. TRANSAKSIONE NË EPARA

Në Smart BanKomaT-et e BKT-së ju keni mundësi të kryeni gjithashtu transaksione në portofolin tuaj digjital në epara, duke përfshirë këtu tërheqje dhe depozitim. Ndiqni hapat në vazhdim për të kryer tërheqje apo depozitim në portofolin tuaj digjital në epara.

### 1. Inicimi i Transaskionit nga aplikacioni epara

Njësoj si Tërheqja apo Depozitimi me Kod QR për të cilin veprimi inicohet nga aplikacioni BKT Smart dhe transaksionet për epara duhet të inicohen nga aplikacioni epara në të cilin ju përcaktoni transaksionin që do të kryeni (tërheqje apo depozitim).

Pasi të keni përfunduar me inicimin e transaksionit në epara ju duhet të vijoni transaksionin në Smart BanKomaT-et e BKT-së për të kryer tërheqjen apo depozitimin e parave tuaja.

### 2. Tërheqja & Depozitimi i parave në Smart BanKomaT

#### 2.1. Aksesimi i menusë epara

Për të kryer tërheqjen apo depozitimin e parave në Smart BanKomaT ju duhet të aksesoni menunë **epara** e cila ndodhet në faqen mirëseardhëse të çdo ATM-je të BKT-së.




## 2.2. Skanimi i Kodit QR

Në ekranin që do t'ju shfaqet, skanoni kodin QR për të kryer depozitimin apo tërheqjen e parave në varësi të transaksionit qe keni inicuar nga aplikacioni epara.



**ANEKSI 1 – Limitet e transaksioneve në Smart BanKomaT**

Për informacion rreth limiteve për veprimet e kryera në Smart BanKomaT ju lutem referohuni Kushteve të Punës të Bankës për klientët Individ dhe Biznes në faqen zyrtare të BKT-së.